



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË

Dt. 21.09.2022 Nr. 400/22

Në mbështetje të nenit 8, paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 5, pika c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 67 të Ligjit nr. 06/L-114 të Ligjit për zyrtaret publik, ,nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal të Komunës së Fushe Kosovës me numër 05.07.2022 me numër 170 për lejimin e mjeteve financiare për punëtorë arsimor, bazuar në Qarkoren Buxhetore të MFPT të datës 13.05.2022 me numër 996/22 faqe 16, dhe vendimit me numër 735 të datës 19.08.2022 Drejtoria për Arsim shpallë:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të punës për kohe të caktuar viti shkollor 2022/23 me mundësi vazhdimi .

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i lirë	Numri i Pozitave
1	SHFMU "Laura Scotti"	Edukator/e për Parafillor	Vend i lirë	1
2	SHFMU "Zejnel Salihu" PNF Pomozotin	Edukator/e për Parafillor	Vend i lirë	1
3	SHFMU "Vëllezërit Frashëri" PNF Vragoli	Edukator/e për Parafillor	Vend i lirë	1
4	SHFMU "Bajram Curri" PNF Henc	Edukator/e për Parafillor	Vend i lirë	1
5	SHFMU "Vëllezërit Frashëri" PNF Miradi e Epërme	Edukator/e për Parafillor	Vend i lirë	1

I. Institucioni: Komuna e Fushë Kosovës

Departamenti/Drejtoria: Drejtoria për Arsim

Lloji i pozitës: Nëpunës/e i/e Shërbimit Publik

Numri i Pozitave: (5) pesë

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori/esha i/e Shkollës

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar për vitin shkollor 2022/23 (me mundësi vazhdimi).

Paga/koefficienti : A 393/1.

II. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Komunë, në Arkiv ose ne web. te Komunës),
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë),
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te Noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh,
- Certifikata që nuk jeni nën hetime,
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

III.Kushtet e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas ligji.

IV. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar, Ligjit Nr.02/L-52, Ligjit Nr.03/L-068 dhe Ligjit Nr.04/L-138, si dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr.05/2021) dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

V. Kriteret e Kualifikimit për Edukator/e për Parafillor :

Përzgjedhja e kandidateve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr. 02/L -52 neni 28.4

- **Diplomën e fakultetit të Edukimit –programi parashkollor;**
- **Shkollës së Lartë Pedagogjike-drejtimi për edukatorë;**
- **Fakulteti Filozofik-dega e Pedagogjisë dhe**
- **Diploma të fakulteteve arsimore, të plotësuara me trajnime adekuate për edukatorë parashkollorë e të certifikuara nga MASHT-i.**

dhe UA nr.05/2021 neni 4 pika 2.1 për normativin mbi kuadrin profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas Ligjit dhe UA nuk do të shqyrtohen përkatësisht refuzohen.

- **Fakulteti i Edukimit –programi katërvjeçar i nivelit bachelor për edukimin parashkollor;**
- **Shkolla e Lartë Pedagogjike –drejtimi për edukatorë;**
- **Fakulteti Filozofik-dega e pedagogjisë së përgjithshme.**

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas Ligjit dhe UA nuk do të shqyrtohen.

VI.Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Kujdes fizik dhe emocional ndaj fëmijëve;
- Mbështetje për mirërritjen e tyre në aspektin fizik, social, emocional, mendor dhe në bazë të nevojave të tyre individuale;
- Të punojë me dy grupe të fëmijëve brenda një institucioni nëse ka mbi 20 fëmijë, në të kundërtën është i obliguar që me grupin tjetër të mbajë mësim në një institucion/ shkollë tjetër. Në të kundërtën, nëse punon vetëm me një grup të fëmijëve, atëherë paguhet me gjysmë norme; 4. Mësimin e rregullave dhe bashkëpunimin në grup;
- Përgatitja e fëmijëve që ata të bëhen të pavarur për gjithçka që kanë nevojë (kur ushqehen, kur pijnë, kur luajnë etj.), të hanë ushqim të pavarur nga të tjerët dhe të krijojnë shprehje të vet ushqyerjes;
- Mbështetje dhe ndihmë psikologjike në rast se fëmija ka vështirësi;
- Kujdes të veçantë për fëmijët me vështirësi të caktuar fizike, psikologjike dhe mendore;
- Respektim të të drejtave të fëmijëve, personalitetit, kulturës dhe prejardhjes;
- Monitorim të përditshëm të zhvillimit të fëmijëve në mjediset e shkollës;
- Mbështetje stafit edukator, me qëllim minimizimin e problematikave ditore dhe të përgjithshme në marrëdhënien dhe komunikim me fëmijët;
- Kujdesin dhe ndjekjen nga afër të fëmijëve me vështirësi të caktuara, në mënyrë profesionale dhe të specializuar, nëpërmjet hartimit të një programi individual dhe mbështetës;
- Informacione psiko-sociale në mbështetje të nevojave të prindërve;
- Hartimi i materialeve dhe dokumenteve të nevojshme për nevojat e institucionit;
- Mirëmbajtje të një ambienti edukativ mikpritës për fëmijë dhe prindër;
- Raportimi i çfarëdo shqetësimi për zhvillimin apo shëndetin e çilitdo fëmijë (individualisht) te drejtori i shkollës.
- Ndërtimi i raporteve dhe komunikimi profesional miqësor dhe bashkëpunues me prindër, kolegë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm;

- Organizimi i takimeve individuale dhe grupe me prindër në nivel grupi;
- Të zhvillojë personalitetin e fëmijës parashkollor dhe ta parapërgatitë atë për shkollë;
- Të sigurojë për secilin fëmijë shanse të barabarta edukimi;
- Të edukojë fëmijën si një qenie të shoqërueshme dhe të aftë për të krijuar marrëdhënie më të tjerët;
- Të zgjerojë përvojën, njohjen, aftësitë ndijore, aftësitë për të vepruar, folur, menduar dhe imagjinuar nëpërmjet ushtrimeve të vazhdueshme;
- Të kontribuojë në edukimin dhe formimin e individit të lirë, të përgjegjshëm dhe pjesëmarrës aktiv në jetën shoqërore;
- Të arrijë përvetësimin dhe aftësimin e kompetencave komunikuese, shprehëse, logjike dhe vepruese;
- Të kryejë detyra të tjera të caktuar nga drejtori apo zëvendës drejtori.

VËREJTJE: Sipas Udhëzimit administrativ (MASHTI) NR.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, neni 7 paragrafi 25, “Të gjithë kandidatët e kualifikuar në nivelin arsimor 300 ECTS për disiplinat nga paragrafi 1-24 të këtij neni, në fakultetet tjera përveç Fakultetit të Edukimit, të cilët i kanë filluar studimet para hyrjes në fuqi të UA nr.06/2015 të datës 10.07.2015, i plotësojnë kriteret për punësim”. neni 11 paragrafi 3, “Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor 300 ECTS, kanë të drejtë të barabartë konkurrimi në arsimin para universitar të paraparë në nenin 6 dhe 7 të këtij Udhëzimit administrativ”.

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar, sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen. Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik kandidatët do t’i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar.

Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar

Vlerësimi në intervistimin me gojë bazohet në këto kriterë:

Njohuritë e përgjithshme - 25 pikë,

Aftësitë e përgjithshme dhe të personalitetit - 35 pikë, dhe

Njohuritë profesionale - 40 pikë (ku përfshihen përvoja e punës dhe kualifikimi profesional gjatë studimeve). Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidati me më shumë pikë do të për zgjidhet në pozitën e lartcekur.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat janë të dëshmuara me dokumente dhe jo ato që janë të deklaruara pa dëshmi.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës, diplomat duhet t’i kenë të nostifikuara nga MASH-i.

Për intervistë do të ftohen ata kandidatë që i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test, intervistë si dhe orari i intervistës do

të publikohen në web faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

<https://kk.rks-gov.net/fushekosove/>

Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2022/2023. Në rast të ndonjë nevojë eventuale për mësimdhënës/e në IEM, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listës së publikuar me rastin e shpalljes së rezultateve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më **22.09.2022** deri më **07.10.2022**

Aplikacioni i kompletuar me të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohet në Komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Arkivit në objektin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Vërejtje: Pas aplikimit kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit e cila është e domosdoshme për fazat e tjera të proceduarave të konkursit.

Adresa: Objekti i Komunës, rruga Tahir Zemaj nr.2, Fushë-Kosovë.

Drejtoria për Arsim
Samir Shahini

